



DREJTORIA PËR SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE MJEDISIT

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Nr.	55
Data:	25.03.2024
Për:	Operatorët Publik dhe Privat që operojnë në Komunën e Fushë Kosovë, si: “KEDS”, “KUR” Prishtina”, “Telekomi i Kosovës, PTK-Vala 900” Ipko, Art Motion, Kujtesa, Tel Kos” dhe të tjera!
Nga:	z. Maliq Berisha - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis,
Përmes:	z. Milaim Shala – Zyrtar për Mjedis- DSHPM / Menaxher i Projektit
Lënda :	NJOFTIM – lidhur me gjendjen aktuale të infrastrukturës nëntokësore në territorin e Komunës së Fushë Kosovës

- I. Të nderuar përfaqësues të Operatorëve të lartcekur, **që operoni në territorin e Komunës së Fushë Kosovës**, ju njoftojmë se: **Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis** së bashku me Drejtorin e Inspeksionit, ka arritur në përfundim se:
- II. Komuna e Fushë Kosovës, gjegjësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis ka marrë Vendim për rregullimin e disa rrugëve dhe shesheve brenda qytetit të **Fushë Kosovës**.
- III. Për vendndodhjen e infrastrukturës suaj nëntokësore në Qytetin e Fushë Kosovës, jeni të obliguar të që deri më datë 29.03.2024, të na informoni me Projekt konkret, duke na dhënë zgjidhje teknike për gjendjen e aseteve tuaja aktuale në formë tekstuale, hartografike dhe skica të detajizuara.
- IV. Përveç rrugës “**Dardania**” brenda Projektit janë paraparë dhe rrugët tjera, si: “**Pajazit Islami**”, “**17 Shkurti**”, “**Shefki Kuleta**”, “**Hajrullah Zymi**”, “**28 Nëntori**”, “**Cajupi**”, “**Xhemajl Mustafa**”, “**Abedin Sogojeva**”, “**Hysen Gjakolli**” dhe “**Hamdi Grajçevci**”.
- V. Me anë të këtijë njoftimi jeni të obliguar të caktoni nga një përfaqësues, në mënyrë që ky projekt të përkrahët dhe të ruhet infrastruktura e juaj.
- VI. Mos respektimi i paragrafit III dhe V nga ana juaj, organi kompetent në këtë rast **Komuna e Fushë Kosovës** dhe **OE** i kontraktuar nuk merr përgjegjësi në rast të dëmtimit eventuale të infrastrukturës tuaj, pasi që mungonë një marrëveshje kontraktuale ndërmjet operatorëve të lartcekur dhe Komunës Fushë Kosovë.

Akti i dorzohet:

Drejtorisë për DSHPM;
Drejtorisë së Inspeksionit;
Operatorëve Publik dhe Privat;
Arhivës.